



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:042442
Datë: 05.04.2024
Numri i dokumentit: 05619386

C.nr. 392/20

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Rajmonda Kurteshi, në çështjen juridike-kontestimore të paditësit Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në Prishtinë, Rr. Lidhja e Pejës, pa nr., të cilën e përfaqëson Kompania “VAR SOLUTION” SH.P.K, me seli në Fushë Kosovë, i përfaqësuar nga Burim Hyseni, sipas autorizimit, kundër të paditurit M.K. nga fshati G., Komuna P., të cilin e përfaqëson Kadri Prekaj, avokat në Pejë, sipas autorizimit, me bazën juridike rimbursim dëmi, vlera e kontestit 8,051.00 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor në prezencë të autorizuarit të paditësit dhe të autorizuarit të paditurit, në seancë publike, të datës 25.03.2024, mori, ndërsa me datën 05.04.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Byroja Kosovare e Sigurimit, (BKS), me seli në Prishtinë dhe **DETYROHET** i padituri M.K. nga fshati G., Komuna P., që paditësit Byroja Kosovare e Sigurimit, (BKS), me seli në Prishtinë, në emër të rimbursimit të dëmit për aksidentit e shkaktuar të datës 30.12.2012 për 80% të përgjegjësisë, t’ia paguaj shumën në lartësi prej 6440.8 euro, me kamatë ligjore prej 8%, duke u llogaritur nga dita e paraqitjes së kësaj padie (18.03.2020) e deri në pagesën përfundimtare.

II. DETYROHET i padituri M.K. nga fshati G., Komuna P., që paditësit Byroja Kosovare e Sigurimit, (BKS), me seli në Prishtinë, detyrimin nga pika I e dispozitivit të këtij aktgjykimi si dhe shumën prej 408 euro në emër të shpenzimeve të procedurës, të ia paguaj në afat prej 15 dite, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përbarimit ligjor.

III. REFUZOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditësit Byroja Kosovare e Sigurimit, (BKS), me seli në Prishtinë, përtej shumës së gjykuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri M.K. nga fshati G., Komuna P., që paditësit Byroja Kosovare e Sigurimit, (BKS), me seli në Prishtinë, në emër të rimbursimit të dëmit për aksidentit e shkaktuar të datës 30.12.2012 për 20% të përgjegjësisë, t’ia paguaj shumën në lartësi prej 1610.2 euro, **si e PABAZUAR.**

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve

Paditësi, me datë 18.03.2020 ka parashtruar padi në këtë gjykatë ndaj të paditurit M.K., me bazë juridike rimbursim dëmi, vlera e kontestit 8.051.00 euro. Në padi, gjatë seancave të mbajtura dhe në fjalën përfundimtare, paditësi përmes të autorizuarit të tij ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesës së sajë, i padituri më datë 30.12.2012, ka shkaktuar aksident trafiku duke shkaktuar dëme familjes L. ketë e vërteton raporti policor i datës 30.12.2012, me numër DR-3004-2.-12, automjeti i shkaktarit të këtij aksidenti konkretisht i të paditurit ka qenë pa mbulesë sigurie ketë e vërteton konfirmimi i policës së sigurimit, bazuar në dispozitat ligjore në padi. Në fund ka shtuar se pas administrimit të provave, konsideron se u vërtetua baza juridike dhe lartësia e saj, andaj, i propozon Gjykatës që ta aprovoj në tërësi si të bazuar padinë dhe kërkesën e saj, duke përfshirë kamatën ligjore nga koha e ngritjes së padisë në lartësi prej 8 përqind, dhe ka kundërshtuar në tërësi deklaratimet e palës së paditur, pasi siç ka deklaruar edhe vet çdo organ shtetëror ka vërtetu fajësinë e palës, ndërsa avokati mbrojtjes na vërtetoj se aksidenti është shkaktuar me qëllim nga pala, duke demonstruar shume mire se si paska mundur ta sheh gjendjen F.L., ndërsa si nuk ka mundur të sheh shkaktarin, duke vozitur një shpejtësi të konstatuar dhe vërtetuar nga policia dhe ekspertet e rastit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë në emër të taksës gjyqësore dhe ekspertizave të përfshira në këtë lëndë.

I padituri përmes të autorizuarit të tij, gjatë seancave të mbajtura dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesën e sajë, duke shtuar se me shikimin shkresave të lëndës ka gjetur se janë bërë shkelje, ishin konstatuar gabimisht veprimet e të paditurit, fillimisht janë dy ekspertiza të ekspertëve të komunikacionit rrugorë të cilat janë në kundërshtim më njëra tjetrën dhe ka gjetur se në procedurën penale edhe pse prokurori kishte propozuar që të nxirret edhe një ekspertizë ose një super ekspertizë që zakonisht është e pranueshme atë nuk e kishte lejuar gjyqtarja e çështjes, në shkresat e lëndës ka parë se në raportin fillestar të policisë dhe në raportin e zgjeruar gjithashtu i padituri ishte shënuar me germën A që do të thotë se ishte fajtor sekondar në atë aksident komunikacioni mirëpo në rrjedhën e më vonshme pranë procedurës penale pranë gjykatës kompetente ishin ndërruar pozitat e përgjegjësve për aksidentin që ishte shkaktuar atë ditë dhe atë 100% sepse i padituri sipas aktgjykimit të kësaj gjykate me numër P.nr..../13, i datës 20.05.2016, ishte shpallur fajtorë ndërsa ndaj pjesëmarrësit tjetër në aksident i cili edhe sipas ekspertizës së parë të punuar nga eksperti N.A., ishte i pa fajshëm për aksident, gjykata me ekspertizën e dytë që e kishte urdhëruar të bëhet e që ishte bërë nga eksperti Ylli Koci, ishte mbete fajtor i vetëm duke e liruar plotësisht nga përgjegjësia pjesëmarrësin tjetër në aksident e trafikut respektivisht vozitësin F.L., konsideron që duke manipuluar me prova është gjykuar jo drejtë çështja sepse i i padituri si fajtorë sekondar doli të jetë 100% fajtorë, aktgjykimin nuk e ka ankim sepse ishte dënim i ultë duke mos i ditur pasojat që rrjedhin pas siç është rasti i rimbursim. E kundërshton edhe një herë padinë dhe kërkesën e saj, të paditurit i janë bërë padrejtësi, duke filluar prej procedurës penale që është zhvilluar nga tij në lëndën penale P.nr..../13, të datës 25.05.2016, ku shihet se i padituri nuk ka pasur avokat të angazhuar në këtë çështje dhe duke parë se i është shqiptuar një dënim i butë, as

nuk e ka ankimuar aktgjykimin, duke u bërë i plotfuqishëm në shkallën e parë, pjesëmarrësi tjetër, sipas këtij aktgjykimi është liruar tërësisht sepse prokuroria i shtetit ka hequr dorë sepse në përshkrimin e veprimit të palës tjetër-të dëmtuarit, ka hequr dorë sepse nuk ka gjetur se i njëjti ka kryer vepër penale, nga super ekspertiza, të cilët ekspertët në disa raste nuk u përgjigjen në pyetjet që i bëri, e kishin një përgjigje, grupi i eksperteve nuk mund të ndërtoj përgjigje në baze të supozimeve, kjo përgjigje ishte në pyetjen time se nëse pjesëmarrësit tjerë në komunikacionit, do të respektonte përparësinë e kalimit dhe nuk do të ndërmernte veprimin e kthimit në të majtë, për tu kyçur në rrugën dytësore, ndërsa, në ekspertizë përgjigjen që ia thanë se nuk ndërtojmë përgjigje në bazë të supozimeve, grupi i eksperteve kishte konstatuar po që se vozitësi i automjetit Reault, të zhvillonte shpejtësinë 50-70 km/h, nuk do të vinte deri të aksidenti i komunikacionit, a do ta lejonin vetën në ekspertizën të vlerësojnë në bazë të supozimeve, në bazë të pyetjes së tij, edhe pse disa here kërkoi që të i japin përgjigje se lëshimet respektivisht shkeljet që i kishte bërë F.L., a ishin shkelje me të rënda sesa shkeljet e rregullta që i kishte bërë i padituri, F.L. kishte bërë shkelje nga neni 41 nga Ligji i Trafikut Rrugor, që sanksionohet me paragrafin 3 të atij nenit, ku gjoha për atë shkelje është e paraparë 100 euro, ndërsa shkeljen e që supozohet që e ka bërë i padituri, është e parapare në nenin 55 të Ligji i Trafikut Rrugor, nr.05/l-088, paragrafi 4, ku parashihet gjoha maksimale prej 60 euro, përpos kësaj, F.L. ka bërë shkelje tjetër nga neni 45 paragrafi 1 të njëjtit ligj, shumë të padrejtë ju ka bërë të paditurit edhe policet e trafikut që kanë qene në vendngjarje, në raportin fillestar edhe në raportin e zgjeruar të policisë rajonale, konstatohet se fajtor-shkaktar primar për aksidentin ishte, F.L. . I ka propozuar gjykatës që ta hudhë poshtë-ta refuzon tërësisht padinë dhe kërkesën e paditësit, kundër të paditurit, sepse i paditur nuk është fajtor për shkaktimin e aksidentit 30.12.2012. Tutje ka shtuar se nuk deklaroi se të gjitha organet e shtetit kanë vërtetuar fajësinë e të paditurit, po kundër policia edhe në raportin fillestar edhe në raportin e zgjeruar ka konstatuar se i padituri ishte fajtor sekondar, ndërsa fajtori primar ishte, F.L., ku e klasifikon të njëjtin në listën e fajtoreve fillestar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar, por nuk i ka specifikuar.

Vërtetimi i gjendjes faktike

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, në shqyrtimin kryesor-publik, gjykata bëri administrimin e provave si: Leximi i transferit nga kontoja me nr.1401000000390119, BKS-Fondi i Kompensimit i datës 14.11.2018; Leximi i urdhër transferi i datës 17.11.2018, e lëshuar nga BKS, me Nr.2074/18; Leximi i marrëveshjes jashtëgjyqësore e lidhur ndërmjet BKS dhe palëve të dëmtuara , F.L. etj, e lidhur me datë 07.11.2018, me Nr.1394/18; Leximi i Aktgjykimit C.nr.../15, i dt.15.10.2018, i lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë: Leximi i Ekspertizës se Komunikacionit nga eksperti Naser Lajqi, për lëndën C.nr.../15; Leximi i raportit të aksidentit me nr.DR-3004 i datës 30.12.2012; Leximi i procesverbalit i dëmit, e lëshuar me datë 05.01.2013, nga Agjencia Ndërmjetësuese e Sigurimeve ANSIIA; Leximi i Aktgjykimit me P.nr.../13, i dt.20.05.2016, i lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë, i plotfuqishëm me datë 20.06.2016; Leximi i parashtrësës së palës paditëse për precizimin e kërkesëpadisë C.nr.../15; Leximi i ekspertizës për llogaritjen e dëmit material për lëndën C.nr.../15, e punuar nga eksperti Avdullah Hoxha; Leximi i super-ekspertiza e përpiluar nga grupi i eksperteve Fisnik Qavolli, Agron Lulaj dhe Vedat

Bajraktari, e datës 07.11.2023, nga lëmia e komunikacionit; Leximi i shkresave të lëndës P.nr.../13, të Gjykatës Themelore në Pejë.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësi është tërësisht e bazuar.

Përgjatë procedurës gjyqësore, si fakt i pa kontestuar rezultoi të jetë se me datën 30.12.2012 është shkaktuar aksidenti i trafiku në të cilin aksident pjesëmarrës ishin i padituri M.K. dhe pala e dëmtuar, F.L. Fazli Lajqi, fakt ky i cili po ashtu u vërtetua nga deklaratimet e palave ndërgjyqëse dhe nga raporti i aksidentit me nr.DR-3004 i datës 30.12.2012.

Kontestues nuk ishte as fakti se i padituri këtu M.K., ishte shpallur fajtor për shkaktimin e aksidentit të datës 30.12.2012, i cili fakt po ashtu u vërtetua nga aktgjykimi P.nr.../13, i datës 20.05.2016, i plotfuqishëm nga data 20.06.2016, i lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë, sipas të cilit aktgjykim, i padituri ishte shpallur fajtor për veprën penal rrezikim i trafikut publik nga neni 297 par.1 e lidhur me par.3 të KPK-së.

Përgjatë procedurës gjyqësore në këtë çështje juridike kontestimore, kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse mbetej përgjegjësia e të paditurit për shkaktimin e dëmit, përkatësisht baza dhe lartësia e kërkesëpadiës, e që për këtë gjë palë ndërgjyqëse kishin pikë pamje të ndryshme.

Nga transferit nga kontoja me nr.1401000000390119, BKS-Fondi i Kompensimit i datës 14.11.2018, gjykata gjeti se këtu paditësi BKS, kishte bërë pagesën përkatësisht transferin e detyrimit në shumën prej 8.051.00 euro, në emër të palës së dëmtuar për familjen L..

Nga urdhëri i transferi i datës 17.11.2018, e lëshuar nga BKS, me Nr.2074/18, gjykata gjeti se paditësi BKS, kishte urdhëruar transferin e mjeteve në shumën totale prej 8.051.00 euro, në emër të kompensimit të dëmit për paditësit palët e dëmtuar, e cila shumën do të paguhej në afatin prej 30 ditësh në llogarinë bankare të autorizuarit të palës së dëmtuar.

Nga marrëveshjes jashtëgjyqësore e lidhur ndërmjet BKS dhe palëve të dëmtuara F.L. etj, e lidhur me datë 07.11.2018, me Nr.1../18, gjykata gjeti se BKS kishte lidhur marrëveshje jashtë gjyqësore me palë e dëmtuar, ku të njëjti ishin dakorduar që shuma në emër të kompensimit të dëmit do të jetë në shumën totale prej 8.051.00 euro.

Nga aktgjykimi C.nr.../15, i dt.15.10.2018, i lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë, gjykata gjeti se ishte aprovuar pjesërisht kërkesëpadia e paditësve F.L. etj, që të gjithë nga Peja dhe është detyruar e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve që paditësve F.L. etj, që të gjithë nga Peja, në emër të kompensimit të dëmit nga baza e autopërgjegjësive për aksidentit e ndodhur me datën 30.12.2012, të paguaj shumat e specifikuar si më poshtë: Paditësit F.L, në emër të dëmit material për dëmin e automjetit shumën prej 801 euro, për shpenzimet e mjekimit shumën prej 10 euro; në emër të dëmit jo material për dhimbje fizike trupore në shumën prej 700 euro, për

frikë në shumën prej 500 euro, për paditësen V.L.M., në emër të dëmit material për shpenzimet e mjekimit shumën prej 6 euro, për shëmtim në shumën prej 2000 euro; në emër të dëmit o materiale për dhimbje fizike trupore shumën prej 1000 euro dhe për frikë shumën prej 700 euro, paditësit D.L. në emër të dëmit material për shpenzimet e mjekimit shumën prej 10 euro, në emër të dëmit jo material për dhimbje fizike trupore shumën prej 700 euro dhe për frikë në shumën prej 500 euro, paditësit A.L. në emër të dëmit material për shpenzime të mjekimit shumën prej 10 euro, në emër të dëmit jo material për dhimbje fizik trupore shumën prej 1000 euro. Dhe të detyrohet e paditura BKS që paditësve, që prestimet e cekura si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi të i paguaj me atë ligjore siç e paguajnë bankat afariste për qytetarët për një vite, duke filluar nga dita e nxjerrës së aktgjykimit e deri në pagesën definitive, në afati prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit e nën kërcim të përmbarrimit me dhunë. Detyrohet e paditura BKS që paditëse të ua paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 2542 euro, më gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarrimit më dhunë. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit përtej pjesës aprovuese për të gjitha llojet e dëmit material dhe jo material si dhe shpenzimet e procedurës refuzohet si e pabazuar.

Nga ekspertiza e komunikacionit nga eksperti Naser Lajqi, për lëndën C.nr../15, gjykata gjeti se si përfundim konstatimet e ekspertit lidhur me shkaktarin e aksidentit është se deri tek aksidenti ka ardhur për shkak të lëshimeve të ngasësit të automjetit B Renault Cango, të cilën këtu e drejtonte i paditurit M.K., ku lëshimet e tija janë se i njëjti ka drejtuar automjetin me shpejtësi të lëvizjes rreth 81 km/h në rrugën me kufizim të shpejtësisë 50 Km/h, (vendbanim), me këtë shpejtësi nuk ka mundur të ndal automjetin kur e ka vërejtur se automjeti Vë 19 e është duke bërë kthimin majtas për tu kyq nga rruga kryesor në rrugën transite. Distanca horizontale e dukshmërisë (52) metra ka qenë e mjaftueshme sikur të kishte lëvizur me shpejtësi konstante – shpejtësi të kufizuar prej 50 Km/h. Në kushte të njëjta sikur të kishte lëviz me shpejtësi më të vogël se 73 km/h do ta ndalte automjetin me frenim të vullshëm.

Nga raporti i aksidentit me nr.DR-3004 i datës 30.10.2012, gjykata gjeti se me datën 30.12.2012 kishte ndodhur aksidenti i trafikut ndërmjetë automjeteve Renault Cango të cilën e drejtonte M.K. dhe VË 19 E të cilën e drejtonte F.L..

Nga procesverbali i dëmit, e lëshuar me datë 05.01.2013, nga Agjencia Ndërmjetësuese e Sigurimeve ANSIIA, gjykata gjeti se për palën e dëmtuar këtu F.L. ishte bërë vlerësimi i dëmeve në makinën e tij i pasojë e aksidentit të datës 30.12.2012.

Nga aktgjykimi P.nr../13, i dt.20.05.2016, i lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë, i plotfuqishëm me datë 20.06.2016, gjykata gjeti se i padituri M.K., si pasojë e shkaktimit të aksidentit me datën 30.12.2012 ishte shpallur fajtor për veprën penal rrezikim i trafikut publik nga neni 297 par.1 e lidhur me par.3 të KPK-së, ndërsa ndaj palë së dëmtuar të pandehurit F.L. që i është refuzuar aktakuza për shkak se prokurori i shteti ka heq dorë nga ndjekja penale dhe aktakuza ndaj tij në shqyrtim gjyqësor.

Nga parashtrësja e palës paditëse për precizimin e kërkesëpadisë C.nr.../15, gjykata gjeti se pala paditësit këtu i dëmtuar kishte bërë precizimin e dëmit material pas pranimit të ekspertizës së makinerisë duke e precizuar kërkesëpadinë në shumën prej 801 euro.

Nga ekspertiza për llogaritjen e dëmit material për lëndën C.nr.../15, e punuar nga eksperti Avdullah Hoxha, gjykata gjeti se eksperti ka konstatuar se nga fotot e marra në polici si dhe nga fotot dhe procesverbalin e dëmit të janë gjendur në shkresat e lëndës, është konstatuar se vlera e automjetit është llogaritur ashtu që pjesët e blera 211 euro, fuqia punëtore 30X10=300 euro, dhe ngjyrosja 290 euro, shuma e vlerës së automjetit është A+B+C është (211+300+290)=801 euro, pra shuma që duhet të paguar të dëmtuar është 801 euro.

Nga super-ekspertiza e përpiluar nga grupi i eksperteve Fisnik Çavolli, Agron Lulaj dhe Vedat Bajraktari, e datës 07.11.2023, nga lëmia e komunikacionit, të njëjtit kanë arritur në përfundim se shkaktar i këtij aksidenti të komunikacionit është drejtuesi i automjetit B si pasojë e lëshimeve të tij i cili në zonën e kufizimit të shpejtësisë së lejuar prej 50 km/h për atë segment rrugor lëvizte me shpejtësi rreth 80 km/h duke shkaktuar aksidentin trafikut në komunikacion rrugor, ndërsa këtij aksidenti i ka kontribuar edhe drejtuesi i automjetit A F.L. i cili ka ndërmarrë veprimin e kthimit majtas nga rruga kryesore për në rrugën transit duke mos qenë i sigurt se me veprimet të tilla nuk rrezikon pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion. Ndërsa në sqarimet e dhëna në seancë të njëjti kanë deklaruar se mbesin pranë super ekspertizës të punuar me shkrim, duke u bazuar në shkresat e lëndës si dhe raportin fillestar të policisë gjatë lëvizjes nacionale Pejë – Prishtinë automjeti A, merr veprim për kthim majtas nga rruga kryesore në rrugën transit, ndërkaq automjeti B po lëvizte në rrugën nacionale Prishtinë Pejë dhe kur e vëren kthimin të automjetit A merr veprim të frenimit të vrullshëm duke lënë gjurmë frenimi 29.55 metra, më pas kemi analizuar teknikisht aksidentin duke gjetur shpejtësinë e lëvizjes të dy automjeteve, shpejtësia e automjetit A ka qenë rreth 15-20 km/h, ndërkaq shpejtësia e automjetit B ka qenë rreth 80 km/h, në zonën ku kufizimi shpejtësisë është 50 km/h, me pas kemi gjetur shpejtësinë me të cilën evitohet aksidenti me frenim të vrullshëm, e cila është 75.16 km/h. Në rast se drejtuesi i automjetit B për rrugën e reagimit 57.24 m, do të lëvizte me shpejtësinë e lejuar për atë segment rrugor e që është 50 km/h, aksidenti nuk do të ndodhte. Rrjedhimisht janë të mendimit që shkaktar ose lëshimet primare në këtë aksident ka drejtuesi i automjetit B, Z. M.K., ndërkaq kontribuues ose lëshime sekondare ka drejtuesi i automjetit A. Z F.L.. Tutje shton se aksidenti ka ndodhur në vitin 2012, ajo rrugë ka qenë siç e kanë paraqitur në ilustrimin në faqen 9, provë për këtë është skica e raportit të policisë si dhe pamja përmes gjeoportalit e cila gjendet në faqen tre të ekspertizës. Ndërkaq tash vendi i ngjarjes ka ndryshuar rruga tani është me 4 korsi. Është konstatuar që shkaktar i këtij aksidenti është shpejtësia me të cilin drejtuesi i automjetit B ka drejtuar automjetin e tij me pas matematikisht kemi gjetur edhe mundësin e evitimit të aksidentit në rast se drejtuesi i automjetit B do të lëvizte me shpejtësinë e lejuar për atë segment rrugor e cila ishte 50 km/h atëherë automjetet nuk do të kishin kontakt ndërmjet vete, matematikisht është e prezantuar në faqen 8 të ekspertizës, tutje shtoj se nuk mundë të ndërtojnë përgjigje në bazë të supozimeve, bazohen në shkresat e lëndës dhe veprimet të cilat kanë marrë të dy drejtuesit e automjetit, ku shkaktar i aksidentit është shpejtësia, nëse drejtuesi i automjetit B do të kishte lëvizur në shpejtësi konstante në 50km/h nuk do të kishte ardhur deri të aksidenti, dukshmëria në kohën e aksidentit ka qenë e kufizuar ora 17:30 natë, shpejtësinë e gjetur nuk e kanë supozuar

por e kanë gjetur në shprehje matematikore prej faqes 6-8 dhe kjo e përjashton atë që është e supozuar ndërkaq lëshimet e automjetit A, është kthimi majtas duke mos qenë i sigurt se me një veprim të tillë rrezikon pjesëmarrësit e tjerë. Me lëshimin e cekur si kthim i pa sigurt majtas i kanë përfshi të gjitha lëshimet sekondare për këtë aksident të drejtuesit A, F.L., gjatë kthimit majtas nga rruga kryesore për në rrugën Transit, të cilën shprehje është cekur në faqen 8 të ekspertizës e mbulon në tërësi, ku kthimi majtas nga rruga kryesore për në rrugën Transit, dhe për atë arsyeje e është lënë kontribuues ose me lëshime sekondare.

Nga shkresat e lëndës P.nr.../13, të Gjykatës Themelore në Pejë, gjykata gjeti se ndaj palës së paditur këtu M.K. dhe F.L., si pasojë e aksidentit të shkaktuar me datën 30.12.2012, ndaj të njëjtëve është zhvilluar procedurale penale, e cila ka përfunduar me aktgjykim meritore P.nr.../13, i 27.04.2016, i plotfuqishëm me datën 20.06.2016, me të cilin aktgjykim, i padituri M.K., si pasojë e shkaktimit të aksidentit me datën 30.12.2012 ishte shpallur fajtor për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 297 par.1 e lidhur me par.3 të KPK-së, ndërsa ndaj palë së dëmtuar të pandehurat F.L. është refuzuar aktakuza për shkak se prokurori i shtetit ka heq dorë nga ndjekja penale dhe aktakuza ndaj tij në shqyrtim gjyqësor. Po ashtu nga ekspertiza e komunikacionit e përpiluar nga eksperti Yll Koshi, me datën 19.02.2015, e cila gjendet në këto shkresa të lëndës, eksperti ka konstatuar dhe ardhur në përfundim se shkaktar kryesor i këtij aksidenti është shpejtësia e madhe dhe palejuar e lëvizjes së veturës B të markës Renault Cango të cilën e drejtonte tani i paditurit me lëshimet e të cilit janë se lëvizja me shpejtësi rreth 88.5 km/h në vendbanim në rrugën ku kufizimi i shpejtësisë ishte 50 km/h, me të cilin rast nuk ka mundur ta ndal mjeti e tij në mënyrë të sigurt me rastin e paraqitjes së veturës Vë golf nëpër ballë kalimit dhe i cili bënte kthimin majtës për të u qyqur nga rruga kryesore në rrugën dytësore. Ngasësi i veturës A i martës Vë Golf, F.L., kthimin majtas e ka bërë duke mos pritur kalimin e veturës B Renault të cilin e kishte përballë që sipas distancës ndërmjet veturave dhe kushteve normale të rrjedhës së komunikacionit dhe kufizimeve në komunikacion ka qenë e sigurt. Ndërsa nga ekspertiza nga lëmia e komunikacionit rrugorë, e përpiluar me datën 10.04.2013 nga eksperti Nexhat Avdijaj, i njëjti ka konstatuar dhe ka ardhur në përfundim se deri tek shkaktimi i aksidentit të trafikut ka ardhur si pasojë e lëshimeve të bëra nga të dy drejtueset e automjeteve të involvuar në aksident, ku lëshimet e drejtuesit të automjetit A VË 19 E, të cilën e ka drejtuar F.L., janë se i njëjti gjatë lëvizjes me automjetin nga drejtimi Pejë-Prishtinë, ku arrin në atë rrugë përballë pompës së benzinës Usa petrol, duke u kthyer në të majtën në rrugë transite, ku këtë veprim e bën në mënyrë të pasigurti, duke ja prere rrugën drejtuesit të automjetit B, i cili ishte duke lëvizur në drejtimin Prishtinë-Pejë në shiritin e vet qarkullues. Ndërsa lëshimet e drejtuesit të automjetit B Renault Cango të cilin e drejtonte M.K. janë se i njëjti deri sa ka qenë duke lëvizur në rrugën Prishtinë-Pejë, e ku arrin në rrugën përballë pompës së benzinës Usa petrol, e godet automjeti A i cili në atë moment ja kishte prere rrugën automjeti B. Shton se automjeti B në pjesën e rrugës ku kufizimi i shpejtësisë ka qenë 50km/h drejtuesi ka lëvizur me shpejtësi prej 77 km/h/. Prandaj shkaktar deri tek aksidenti kanë qenë lëshimet e dy drejtueseve.

Baza Ligjore

E drejta e paditësit për rimbursimin e dëmit ka lindur që në momentin e përmbushjes së detyrimit të tij në cilësi të debitorit ndaj palës së dëmtuar dhe përgjegjësia e të paditurit që të bëjë kompensimin e tillë, gjen mbështetje fillimisht duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-077 për

Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) përkatësisht në dispozitën e nenit 136 par.1 i cili parasheh se: *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*, e lidhur me nenin 176 par. 1 i cili parasheh se: *“I dëmtuari i cili ka kontribuar që dëmi të krijohet ose të jetë më i madh se sa përndryshe do të ishte, ka të drejtë vetëm në shpërblimin përpjesëtimisht të pakësuar”*, e lidhur me nenin 960 paragrafi 1 i cili parasheh se: *“Me pagimin e shpërblimit nga sigurimi kalojnë në siguresin në bazë të ligjit deri në shumën e shpërblimit të paguar të gjitha të drejtat e të siguruarit kundrejt të gjithë personave, të cilët mbi çfarëdo baze janë përgjegjës për dëmin”*, e lidhur me nenin 281 të njëjtit ligj i cili parasheh se: *“Kur detyrimin e përmbush personi i cili ka ndonjë interes juridik në këtë çështje, atëherë i kalojnë këtij, në bazë të vet ligjit, në çastin e përmbushjes, kërkesat e kreditorit me të gjitha të drejtat aksesore”*, e lidhur me nenin 245 paragrafi 1 sipas të cilës dispozitë ligjore parashihet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*.

Gjykata gjithashtu aplikoi edhe Ligjin për Sigurimet e Detyrueshëm nga Auto-përgjegjësia Nr. 04/L-018, i cili në nenin 18 par.1 dhe 4 parasheh se: *“Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i auto përgjegjësive, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja”* dhe *“Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat”*.

Vlerësimi i Gjykatës

Gjykata, pas analizimit dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës dhe bindjes së lirë profesionale si dhe duke u bazuar në dispozitat e lartcekura, ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar, ngase ndërmjetë palëve ndërgjygjëse në rastin konkret kemi ndarje të përgjegjësive dhe atë me përgjegjësi primare për të paditurit për 80% të përgjegjësive dhe përgjegjësi sekondare për 20% për palën e dëmtuar përkatësisht për paditësin në rastin konkret, në shkaktimin e aksidentit të ndodhur me datën 30.12.2012. Deri tek ky përfundim gjykata erdhi pas që nga super-ekspertiza e përpiluar nga grupi i eksperteve Fisnik Çavolli, Agron Lulaj dhe Vedat Bajraktari, e datës 07.11.2023, nga lëmia e komunikacionit, u vërtetua se aksidenti i komunikacionit ka ndodhur me datën 30.12.2012, rreth orës 17:30, në afërsi të pompës së benzinës USA – H, në Pejë, ku vendi i aksidentit është brenda zonës urbane, ku kufizimi i shpejtësisë është 50km/h, me rrugë të asfaltuar, asfalt i terur dhe udhëkryq. Në ditën e aksidentit periudha kohore ishte natë, dukshmëria ishte e kufizuar dhe kohë e mire. I padituri (i cili e drejtonte automjetin B) me të vërejtur rrezikun ka reaguar me frenim duke lënë gjurmë në distance prej 29.55 meta, shpejtësia e lëvizjes së të cilit para shkaktimi të aksidentit ishte 80 km/h në zonën ku kufizimi i shpejtësisë është 50km/h, ku rrugën të cilën automjeti B duhet ta përshkruar për ndaljen e automjetit të tij për shpejtësinë e lëvizjes prej 80 km/h është 62.73m, ndërsa për shpejtësinë e lejuar në këtë zonë rruga e ndaljes së automjetit B është 31.09 m. Rruga e reagimit të automjetit B prej kur e ka vërejtur pengesën në rrugë, përkatësisht kthimin e automjetit A deri tek pika e goditjes është 57.24 m. Shpejtësia me të cilën dhe nën të cilën do të evitohet aksidenti me frenim të vrullshëm nga ana e drejtuesit të automjetit B do të ishte $V_s <$

75.16 km/h. Automjeti B nëpër rrugën e reagimit Sr+57.24m po të lëvizte me shpejtësinë e lejuar 50 km/h atëherë këtë distancë do ta kalonte për kohën $t+4.12s$. ndërsa drejtuesi i automjeti A kryen veprimin e kthimit majtas për në rrugën transit dhe këtë veprim e ka marr duke mos qenë i sigurt se një veprim të tillë mund ta kryej pa i rrezikuar pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion andaj dhe si përfundim është ardhur se shkaktar i këtij aksidentit të komunikacionit është drejtuesi i automjetit B si pasojë e lëshimeve të tij i cili në zonën e kufizimit të shpejtësisë së lejuar prej 50 km/h për atë segment rrugor lëvizë me shpejtësi rreth 80 km/h duke shkaktuar aksidentin trafikut në komunikacion rrugor, ndërsa këtij aksidenti i ka kontribuar edhe drejtuesi i automjetit A F.L. i cili ka ndërmarrë veprimin e kthimit majtas nga rruga kryesore për në rrugën transit duke mos qenë i sigurt se me veprimet të tilla nuk rrezikon pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion, ku dhe në sqarimet e dhëna në seancën e shqyrtimit kryesore të datës 05.03.2024, kanë theksuar se u bazuar në shkresat e lëndës si dhe raportin fillestar të policisë gjatë lëvizjes nacionale Pejë – Prishtinë automjeti A, merr veprim për kthim majtas nga rruga kryesore në rrugën transit, ndërkaq automjeti B po lëvizte në rrugën nacionale Prishtinë Pejë dhe kur e vëren kthimin të automjetit A merr veprim të frenimit të vullshëm duke lënë gjurmë frenimi 29.55 metra, ku është gjetur shpejtësia e lëvizjes të dy automjeteve, shpejtësia e automjetit A ka qenë rreth 15-20 km/h, ndërkaq shpejtësia e automjetit B ka qenë rreth 80 km/h, në zonën ku kufizimi shpejtësisë është 50 km/h, duke shtuar se shpejtësinë me të cilën evitohet aksidenti me frenim të vullshëm, e cila është 75.16 km/h. Në raste se drejtuesi i automjetit B për rrugën e reagimit 57.24 m, do të lëvizte me shpejtësinë e lejuar për atë segment rrugor e që është 50 km/h, aksidenti nuk do të ndodhte. Rrjedhimisht duke ardhur në përfundim se shkaktar ose lëshimet primare në këtë aksident ka drejtuesi i automjetit B, Z. M.K., ndërkaq kontribuues ose lëshime sekondare ka drejtuesi i automjetit A. Z. F.L., të cilës ekspertizës, gjykata, i ka falur besimin ngase e njëjta ishte e punuar dhe argumentuar në mënyrë profesionale.

Gjykata, ekspertizave të tjera nga lëmia e komunikacionit të punuara nga ekspertet Naser Lajqi, Nexhat Avdiya dhe Yll Koshi, të njëjtave nuk iu fali besimin për faktin se të gjitha ekspertizat njëra më tjetrën kishin kundërthënie.

Përgjegjësia e të paditurit për shkaktimin e aksidentit të datës 30.12.2012, gjithashtu u vërtetua edhe nga aktgjykimi penal të lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë, P.nr../13, i datës 20.05.2016, i plotfuqishëm nga data 20.06.2016, ku gjykata gjeti se drejtuesi i automjetit këtu i padituri M.K., ishte shpallur fajtor veprën penal rrezikim i trafikut publik nga neni 297 par.1 e lidhur me par.3 të KPK-së, ndërsa ndaj palë së dëmtuar të pandehurit F.L. është refuzuar aktakuza për shkak se prokurori i shteti ka heq dorë nga ndjekja penale dhe aktakuza ndaj tij në shqyrtim gjyqësor, e që konform dispozitës ligjore të nenit 14 të LPK-së, i cili nen parasheh se: *“Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor”*, gjykata është lidhur për aktgjykimin në fjalë.

Sa i përketë lartësisë, gjykata erdhi në përfundim se e njëjta u vërtetua nga aktgjykimi C.nr../15, i dt.15.10.2018, i lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë, transferit nga kontoja me nr.140100000390119, BKS-Fondi i Kompensimit i datës 14.11.2018, urdhëri i transferi i

datës 17.11.2018, e lëshuar nga BKS, me Nr.2074/18 si dhe nga marrëveshja jashtëgjyqësore e lidhur ndërmjet BKS dhe palëve të dëmtuara F.L. etj, e lidhur me datë 07.11.2018, me Nr.1394/18, se pala paditëse këtu BKS kishte bërë kompensimin e dëmit në shumën totale prej 8.051.00 euro ndaj palëve të dëmtuara si pasojë e aksidentit të shkaktuar me datën 30.12.2012. Për kundër faktit se pala paditëse kishte bërë kompensimin e dëmit ndaj palës së dëmtuar në shumën e lartcekura përkatësisht të kërkuar si në kërkesëpadi, meqenëse për gjykatën rezultoi se kemi ndarje të përgjegjësisë, ku 80% të përgjegjësisë, i përket të paditurit ndërsa për tani paditësin në 20% të përgjegjësisë, e njëjta erdhi në përfundim se shumën e aprovuar për rimbursimin e dëmit si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi erdhi në përputhje me ndarjen e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar nga aksidentit meqenëse kontribues ishin i padituri si dhe pala e dëmtuar.

Sipas dispozitës së nenit 7 të LPK-së, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta, dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla, ndërsa sipas dispozitës së nenit 319 të LPK, secila palë ndërgjyqës, ka për detyrë të provoi faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta.

Andaj, meqenëse i padituri me asnjë provë tjetër, nuk e ka argumentuar të kundërtën e dëmit të pretenduar, gjykata e vënë para një situatë të tillë dhe duke u bazuar në këtë gjendje faktike erdhi në përfundim dhe vërtetoi se ekziston detyrimi juridik - civil, ndaj paditësit për rimbursimin e dëmit, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 245 par.1 të LMD-së, si rezultat i kësaj paditësi ka paguar dëmin që e ka shkaktuar i padituri, me ç' rast i padituri ka hyrë në raport të detyrimeve me paditësin, në të cilin raport paditësi e ka cilësinë e kreditorit kurse i padituri e ka cilësinë e debitorit.

Gjykata me rastin e vendosjes mori për bazë të gjitha provat të administruara në shqyrtimin gjyqësor mirë po të njëjta nuk kishin ndikim që të vendoset ndryshe.

Gjykata, vendosi si në pikë e III (tretë) të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke e refuzuar kërkesëpadinë përtej shumës së gjykuar, meqë nga provat e administruara, e njëjta erdhi në përfundim se në shkaktimin e dëmit përkatësisht aksidentit të datës 30.12.2012 përpos këtu palës së paditur që ishte kontribues primar i shkaktimit të dëmit, njëkohësisht edhe pala e dëmtuar ishte kontribues sekondarë i shkaktimit të dëmit, andaj meqenëse sipas dispozitave ligjore të lartcekura është paraparë se pala e dëmtuar ka të drejtën në shpërblimin përpjesëtimisht të pakësuar këtu pala paditëse, atëherë gjykata vlerësoi se shumën e refuzuar është në përpjesëtim të drejtë më kontributin e palës së dëmtuar më shkaktimin e aksidentit.

Për kamatën, gjykata vendosi duke u mbështetur në dispozitat e nenit 382 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve e në lidhshmëri me Mendim Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës, meqenëse paditësi detyrimin e tij ndaj palës së dëmtuar e ka përmbushur gjatë periudhës sa është në fuqi ky ligj dhe meqenëse sipas dispozitës së lartcekur, neni 382 paragrafi 2 të LMD-së, parashihet se lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë, e cila do të llogaritet nga dita e ushtrimit të

padisë së paditësit 18.03.2020, atëherë gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të LPK-së përkatësisht në dispozitat ligjore të nenit 449 par.1 i cili para sheh se: *“Shpenzimet procedurale përbëhen nga harxhimet e bëra gjatë dhe lidhur me procesin gjyqësor”* e lidhur me nenin 463 par. 1 dhe 2 i cili parasheh se: *“Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën”* dhe *“Pala ka për detyrë që në kërkesën e saj në mënyrë të specifikuar t’i tregoj shpenzimet për të cilat kërkon shpërblim, duke parashtruar prova për shpenzimet e bëra, po që se nuk ekzistojnë provat e tilla në dosjen e lëndës”*, e lidhur me nenin 452 par.2 i cili parasheh se: *“452.2 Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t’ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve, duke marrë parasysh suksesin e paditësit në këtë procedurë dhe provave të bashkangjitura në shkresat e lëndës, lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara i referohen shpenzimeve të palës paditëse dhe atë në emër të taksës gjyqësore dhe super ekspertizën nga lëmia e komunikacionit, në përputhje me suksesin e paditësit duke njohur pjesërisht shumën prej 408 euro, ndërsa pjesa tjetër prej 102 euro në emër të shpenzimeve, u refuzua si e pabazuar.*

Nga arsyet e cekura si më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 143 të LPK - së.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.392/20, me datë 25.03.2024

Gjyqtarja,
Rajmonda Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi, nëpërmjet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.